



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Br	252/18
Nr. i fq. / Br. st	- 13 -
Data / Datum	27. 09. 2018
VUSHTRRA - VUČITRA	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 KORRIK 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Rrezarta Krasniqi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës - z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Në fillim të mbledhjes Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë mbajti një minutë heshtje në nderim të heroit të Kosovës Enver Zymberi.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - pasi i përshëndeti të pranishmit, njoftoi kuvendin për gjendjen pas të reshurave atmosferike, ku ceku se në disa fshatra siç janë: Dumnica, Stanoci i Poshtëm dhe Stanoci i Epërm, Maxhunaj dhe Lumadh nga të reshurat e mëdha janë vërsuar. Kjo gjendje është krijuar si pasojë e shirave të vazhdueshme dhe të dendura me çka ka rezultuar që rruga magjistrale Mitrovicë-Prishtinë është bllokuar për disa orë. Për sanimin e kësaj në terren kanë dal ekipet emergjente së bashku me Policinë e Kosovës dhe e kanë zhbllokuar rrugën në fjalë. Pastaj ai njoftoi se gjendja ka qenë e rënduar sidomos në fshatin Maxhunaj afër bazës së KFOR-it ku ujërat sipërfaqësore kanë vërsuar dhe kjo edhe për faktin se infrastruktura në atë lokalitet është e vjetruar dhe aty duhet të intervenohet me një projekt të ri. Lidhur me këtë problematikë ai në cilësinë e kryetarit të komunës ka zhvilluar një takim me komandantin e KFOR-it, si dhe në një takim tjetër me inxhinierët e FSK-së dhe KFOR-it është diskutuar hartimi i një projekti për eliminimin e këtij problemi. Po ashtu edhe në fshatin Stanoc ka pasur vërsime dhe është intervenuar nga autoritetet kompetente, për sanimin e gjendjes, ku ka pasur edhe konsultime me zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës, që në projektin për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Mitrovicë të bëhet rregullimi i rrjedhës së ujërave natyrore dhe atyre sipërfaqësore në të gjitha lokacionet ku ujërat rrjedhin nga lartë poshtë rrugës

magjistrale. Gjithashtu ai prezantoi para kuvendit një pikë shtesë të rendit të ditës, propozimin për çmimin “Hasan Prishtina” për Enver Zymberin (post mortum). Në fund i uroi të gjithë anëtarët e kuvendit dhe gjithë zyrtarët për vendosjen në objektin e ri të komunës.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – tha se për heronjtë nuk ka një minutë heshtje, por një minutë nderim, pastaj njoftoi se në fshatin Maxhunaj gjatë ditës së djeshme ka mbretëruar një gjendje kaotike dhe e jashtëzakonshme pas reshjeve atmosferike, në ç’rast qytetarët kanë kërkuar kontaktin e parë me kryetarin, ku ky i fundit nuk ka shfaqur interesimin e tij për t’i takuar qytetarët dhe pas kësaj banorët e fshatit Maxhunaj janë rikthyer në fshat në ç’rast ka ndodhur një revoltë ku ata kanë qenë të gatshëm ta bllokojnë rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, porse me insistimin e tij dhe të Kadri Maxhunit është shmangur kjo situatë. Në fund tha se qytetarët në vështirësi kanë nevojë që t’u zgjatet dora dhe t’u jepet një fjalë e mirë, por kjo nga kryetari i komunës është bërë me vonesë. Lidhur me këtë problematikë ai kërkoi që të themelohet një komision për vlerësimin e dëmeve që janë shkaktuar në fshatin Maxhunaj.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – njoftoi se gjatë takimit me qytetarë ku janë zhvilluar dëgjimet buxhetore janë identifikuar shumë kërkesa për problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët, ndër të tjera ai potencoi se në fshatin Novolan rruga “Agim Kadriu” në gjatësi rreth 1 km është e pakalueshme, në fshatin Duboc rr.”Zenun Avdulli” rreth 300 m po ashtu është e pakalueshme, në fshatin Samadrexhë rr.”Shyqyri Rashani” në drejtim të Dumnicës në gjatësi prej 1300 m gjatë sezonës së dimrit kjo rrugë është e pakalueshme. Pastaj në fshatin Maxhunaj shumë shtëpi janë të rrezikuara nga vërshimet në rr. “Paqja”, në fshatin Sfaracak rr.”Rushit Halili” rreth 720 m gjatë sezonës vjeshtë-dimër, fëmijët e këtij lokaliteti nuk mund të shkojnë në shkollë, në fshatin Stanoc i Epërm në rrugën e familjes Avni Bregaj në gjatë prej 150 m, për të gjitha këto kërkesa banorët e këtyre lokaliteteve kërkojnë që në këto rrugë të intervenohet me shtrimin e tyre me zhavorr, me qëllim që këto rrugë të bëhen të kalueshme gjatë stinës së dimrit, lidhur me këtë kërkoi nga DSHP-ja që në këto rrugë të intervenohet para dimrit. Tutje në fshatin Pantinë në lagjen e “Barelive” kemi mungesë totale të kanalizimit si kështu kanoset rreziku i përhapjes së ndonjë epidemie dhe rreziku i paraqitjes së gjarpërinjve. Në fshatin Stanoc i Epërm po ashtu kanalizimi është i bllokuar i cili vijën nga fshati Breznicë, ku janë të lidhur disa lagje si: lagja “Shala”, “Haradinaj”, “Maloku”, “Billaca”. Ky projekt ka qenë i përbashkët mes Komunës së Vushtrrisë dhe asaj të Obiliqit dhe mund të thuhet se ky projekt është i dështuar. Banorët e fshatit Druar kanë kërkuar rregullimin e kroit të fshatit pasi që nuk kanë ujë të pijes sepse shumë familje furnizohen me ujë nga ky krua. Në fshatin Samadrexhë familja e Ragip-Kamer-Bunjaku është e rrezikuar pasi shtëpia e tyre është shumë e demoluar, dhe për qëndrueshmërinë e kësaj shtëpie kemi edhe konstatimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe gjithashtu kemi edhe një komision për vlerësimin e dëmtimit të asaj shtëpie, lidhur me këtë çështje ai lexoi para kuvendit vendimin e nxjerr në vitin 2013, ku konstatohet rreziku i rrënimit të kësaj shtëpie dhe rrezikimi i asaj familjeje, për këtë ai kërkoi nga komuna që të intervenohet sa më parë për ndërtimin e një shtëpie për atë familje.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – kërkoi nga kryetari i komunës që të ofrojë informatë, lidhur me procedurën e përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Aksionarëve, ku kërkoi të sqarohen se anëtari i cili është zgjedhur a i ka plotësuar kushtet e konkursit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – në emër të Lëvizjes për Bashkim kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës, pika e pestë (5) në renditje Propozim-vendimi për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri, pasi për këtë çështje përsëriti se duhet të mblidhen të gjitha partitë politike të përfaqësuar në kuvend dhe ta vendosin këtë çështje, pasi që nuk është e përshtatshme që oborri i komunës të emërohet shesh me emrin e Ahmet Krasniqit. Tutje ai foli për biografinë dhe veprimtarinë patriotike të Ahmet Krasniqit duke spikatur: Ahmet Krasniqi ishte pjesëtar i Lëvizjes Kombëtare të patriotit Metush Krasniqi. Në janar 1997, koloneli Ahmet Krasniqi - më vonë ministër i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës - ka kërkuar organizim ushtarak të shqiptarëve të Kosovës.

Për këtë ekziston një shkresë me të cilën ai iu është drejtuar Ibrahim Rugovës, Sali Berishës dhe Bujar Bukoshit. Një familjar thotë se po synohet që përmes figurës së ish-ministrit të fitohen poena politike. Në këtë rast, kushëriri dhe bashkëpunëtori i Krasniqit, kërkon që figura e eprorit të tij të kursehet nga debatet e tilla. Pastaj njëri nga themeluesit e LDK-se shkruan: “E vërteta është se Ahmet Krasniqi ka qenë ministër i mbrojtjes në qeverinë e Bukoshit, por ka qenë i zgjedhur nga Bukoshi, e jo nga LDK-ja. LDK-ja nuk e ka pranuar Ahmetin si ministër të vetin! Këtë e di nga dora e parë, pasi kam pasur nderin ta takoj në maj 1998 në Tiranë dhe të bisedoj gjatë me të. Bile, kërkesat e tij ia kam përcjellë direkt Rugovës. Por, Rugova pati refuzuar të merrte ndonjë obligim, duke më thënë se Bujari “ia ka marrë kuletën!”, ka shkruar ndër tjera Krasniqi. “Ky shefi është djalë i ri dhe flet për gjëra që nuk i di”, ka thënë Krasniqi. A ka më të turpshme se sa të tentojmë t’i politizojnë edhe dëshmorët duke i shantazhuar familjet e tyre. Dëshmorët nuk luftuan për partitë e juaja, ata dhanë jetën për popullin e lirë. Andaj: Mos bëni politikë me emrin e Ahmet Krasniqit, sepse këto deklarata po i shqetësojnë familjarët e kolonelit. Të nderuar anëtarë të kuvendit, bëhuni shembull i mirë, jo vetëm për vete, por edhe për anëtarët e kuvendit të ardhshëm, që të fillojë epoka për mbrojtjen e interesit të qytetarëve të komunës e jo të liderëve që matën me “hijen e mëngjesit”.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit – tha se të flasësh për familjen e Ahmet Krasniqit, nevojiten faqe të tëra dhe ditë të tëra pasi që Ahmet Krasniqi dhe familja e tij janë emblemë e lirisë së Kosovës. Andaj ai vlerësoi se pika për emërtimin e këtij sheshi jo që duhet të hiqet nga rendi i ditës, por ajo duhet të aprovohet me unanimitet të plotë.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – kërkoj që të futet në rend të ditës propozimi për ndërtimin e shtëpisë së Hajredin Dragidellës, pasi ati i është djegur shtëpia.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - sqaroi se mjetet financiare për ndërtimin e shtëpisë së Hajredin Dragidellës janë siguruar nga shoqata “Jetimët e Ballkanit”, kurse shumën prej 1000 € do ta ndajë Komuna e Vushtrrisë me vendim të kryetarit të komunës, gjithashtu për këtë kanë kontribuar edhe qytetarët ku mjetet janë derdhur në llogarinë e shoqatës “Jetimët e Ballkanit”.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se njëri nga sheshet e dinjitetshëm të qytetit meriton të mbajë emrin e Ahmet Krasniqit, dhe shtoi se nuk është në rregull që parkingu i objektit të mbajë emrin e Ahmet Krasniqit. Në këtë kontekst ai kërkoj nga Drejtoria e Urbanizimit që konfiguracionin e këtij sheshi ta paraqesë përmes monitorit, ku do të dihej saktë pozicioni i këtij sheshi dhe se a po preket sheshi “Hasan Prishtina” nga sheshi “Ahmet Krasniqi”, në këtë mënyrë do të kishim një pasqyrim të saktë dhe të drejtë për këtë çështje dhe kjo çështje do të aprovohej në mënyrë unanime dhe kështu do t’i shmangemi ndarjeve dhe politizimit të kësaj çështjeje.

Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës, kuvendi me vota unanime aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 28.06.2018;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2018;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit lidhur me pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Raportit janar-qershor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtri;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës janar-qershor 2018;
7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018;

8. Shqyrtimi i Informatës për sigurinë ushqimore;
9. Të ndryshme.
- a). Shqyrtimi i Draft-Memorandumit të Bashkëpunimit i lidhur mes Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës, Skënderajt, Drenasit dhe Obiliqit;
- b). Shqyrtimi i Draft-Planit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018 (shqyrtimi i dytë);
- c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ejonë Hasanin;
- ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për Arben Krasniqin;
- d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e çmimit “Hasan Prishtina” për Enver Zymberin (post mortum);
- dh). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se është hera e dytë që përmes lojërave politike kinse në emër të shtyrjes për të gjetur një lokacion më të mirë për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” partitë politike (PDK dhe LB), tentojnë të manipulojnë dhe që këtë çështje ta prolongojnë deri në pafundësi. Tutje shtoi se për dymbëdhjetë vitet e qeverisjes së kaluar është parë se si është nderuar figura e Ahmet Krasniqit ku asnjë rrugë nuk i është dhënë emri i tij. Pastaj duke iu referuar sheshit “Shote dhe Azem Galica” krahasoi se qeverisja e kaluar ka përdorë një standard tepër të tejkaluar dhe të dobët të punës (duke printuar një hartë të thjesht nga elaborati kadastral). Në vazhdim ai ceku se edhe sot në saje të një dinakërie politike u tentua të shtyhet kjo çështje. Por ndodhi e kundërta dhe për këtë ai falënderoi anëtarët e kuvendit që votuan për futjen në rend dite të kësaj çështjeje për ta nderuar heroin e Kosovës Ministrin e parë të Republikës së Kosovës Ahmet Krasniqin. Në fund i uroi qytetarët për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi”.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 28.06.2018

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 28.06.2018.

1. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2018

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – pasi e përgëzoi komandantin e policisë për punën e bërë e vlerësoi lartë bashkëpunimin e mirë mes kryetarit të komunës dhe strukturave të sigurisë, ku falë bashkëpunimit të treguar kemi rënie të numrit të veprave penale krahasuar me vitin e kaluar.

Muhamet Alidema, komandant i Stacionit Policor në Vushtrri - paraqiti të dhëna shtesë lidhur me informatën për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2018, duke ofruar statistika lidhur me numrin e veprave penale kundër jetës dhe trupit të njeriut, kundër pronës, si dhe kundërvajtjet në trafik ku gjithashtu paraqiti edhe një komperacion të krimeve për këtë periudhë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – pyeti lidhur me veprat penale kundër narkotikëve dhe sigurisë në trafik, ku vlerësoi se këtu duhet pasur fokus organet e rendit sidomos tek përdorimi i narkotikëve nëpër shkolla. Tutje shtoi se në informatë shkruan shitja e paautorizuar e substancave narkotike për këtë pyeti se a ka shitje të autorizuar të këtyre substancave. Pastaj vlerësoi se është shumë imediate dhe tepër e nevojshme bashkëpunimi i policisë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në sensibilizimin dhe mbajtjen e ligjëratave nëpër shkolla ashtu që të zhvillohet lufta në preventivë kundër përdorimit

të narkotikëve nëpër shkolla. Në fund tha se edhe para disa viteve e kishte ngritur çështjen e lejeve qarkulluese të traktorëve, biçiklistëve dhe motoçiklistëve, se lëshimi i këtyre lejeve në kompetencën e kujt është pasi që këta participantë shpesh janë subjekt të aksidenteve në komunikacion, por për këtë nuk kishte marrë asnjëherë përgjigje.

Muhamet Alidema, komandant i Stacionit Policor në Vushtrri - duke u përgjigjur në pyetjen e anëtarit të kuvendit njoftoi se kanë kapacitete solide në luftën kundër përdoruesve të narkotikëve dhe atë duke filluar nga aspekti i hetimit, zbulimit dhe arrestimit të këtyre personave dhe për këtë çështje ekziston njësi i veçantë.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – pyeti se ka orar të caktuar sa i përket zhurmave të shkaktuara nga dasmat dhe ahengjet, pasi që në këta muajt e verës ka një fluks të këtyre organizimeve në ç'rast krijohen shumë zhurma dhe pengohet komuniteti, dhe kështu po krijohet një kulturë shumë e keqe, kurse ai apeloj se kjo do të mund të parandalohet vetëm duke shqiptuar gjoba.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – pyeti lidhur me shfrytëzuesit e zhavorrit nga lokaliteti nga ai vjen dhe lokalitetet tjera, ku këta shfrytëzues bartin me kamion pesha të rënda të këtyre materialeve, dhe gjatë rrugës nga këta kamion bien shpeshherë këto materiale dhe kështu rrezikohen pjesëmarrësit tjerë në komunikacion. Për këtë pyeti se këta kamionë a kontrollohen nga policia rrugore lidhur me peshat që bartin dhe lidhur me pajisjet që duhet t'i vendosin për mënjanimin e këtyre problemeve në rrugë.

Muhamet Alidema, komandant i Stacionit Policor në Vushtrri - sqaroi se nga njësia e trafikut rrugor kemi kontrole të mjeteve transportuese lidhur me peshat e ngarkuara dhe nëse vërehet se kemi tejkalim të limiteve të këtyre masave pason shqiptimi i gjobave.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - falënderoi komandantin e policisë për bashkëpunimin e treguar me strukturat komunale, ku falë këtij bashkëpunimi kemi rënie të numrit të krimeve në komunën tonë. Tutje shtroi problemin e kolonave të gjata të automjeteve që po shkarkohen në hyrje të qytetit ku po ka vonesa të qytetarëve për shkak të shkarkimit nga korsitë e autostradës në fshatin Lumadh, por për këtë falënderoi zyrtarët policorë nga Drejtoria rajonale e policisë dhe stacioni policor, ku zyrtarët policorë çdo ditë nga ora 16:00 drejtojnë komunikacionin që të kemi sa më pakë vonesa. Në fund falënderoi komandantin për asistimin e policisë në task-forcën për parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm dhe kundër gjuajtjes së mbeturinave.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit lidhur me pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se raporti i auditorit të përgjithshëm për pasqyrat financiare për vitin 2017 pasqyron një gjendje të drejt dhe të plotë të kryerjes së obligimeve financiare vjetore të paraqitura në praktikat më të mira të performancës financiare duke u bazuar në llogaridhënien dhe transparencën e qeverisjes komunale të raportuara në raportin financiar vjetor të Komunës së Vushtrrisë. Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës me numër të dokumentit 21.4-2017-08 në maj të vitit 2018 ka nxjerr raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018 dhe opinionin i auditorit është “opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes” dhe konstatimi se pasqyrat vjetore financiare për vitin 2017 paraqesin një pamje të drejtë dhe të plotë në të gjitha aspektet materiale dhe financiare. Opinionin i auditorit të përgjithshëm tregon se qeveria e kaluar në vitin e kaluar financiar ka realizuar 91% të buxhetit, të hyrat vetanake janë realizuar në masën 87% nga ato të planifikuara për vitin 2017. Mandej performancë jashtëzakonisht të mirë sipak opinionin i auditorit edhe sa i përket planifikimit të buxhetit për investime kapitale, gjithsej komuna kishte planifikuar 107 projekte kapitale dhe se për të gjitha këto projekte konstatimi i auditorit është se të gjitha këto projekte janë përfshirë në programin e investimeve publike në mënyrë të drejtë. Raporti i auditorit konstaton disa lëshime në disa aspekte dhe për të njëjtën jep rekomandime, por e rëndësishme në këtë drejtim është se në të gjitha rekomandimet e bëra nga auditori i përgjithshëm nuk është vërejtur rrezik i shkallës së mesme apo të lartë i dëmtimit

të buxhetit të komunës. Këto lëshime janë evidentuar si të gjetura me rrezikshmëri të ulët dhe për to jepen rekomandime konkrete me qëllim që të njëjtat mos të përsëriten në të ardhmen. Në fund tha se raporti i auditorit ka nxjerr se pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë janë të pasqyruara drejt dhe për këtë e përgëzon qeverinë e kaluar për punën e mirë që ka bërë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi Raportin e auditimit lidhur me pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017.

4. Shqyrtimi i Raportit janar-qershor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – duke iu referuar raportit në fjalë, sa i përket shpenzimeve të nivelit të lartë lidhur me investimet kapitale, në këtë aspekt shihet rreziku i lartë dhe performanca jo e mirë e qeverisë komunale. Përmbledhja tabelare tregon se kjo qeveri nuk do të mund të shpenzojë buxhetin deri në fund të vitit ashtu siç është planifikuar dhe kjo do ta dëmtojë seriozisht komunën. Rreziku i dëmtimit të buxhetit arsyetohet me faktin se te kodi ekonomik 300 përqindja e buxhetit të alokuar është 12% dhe kjo nënkupton se buxhetin e zotuar do ta humbim në fund të vitit, andaj buxheti i cili iu është ndarë qytetarëve të Vushtrrisë do të shkojë në suficit dhe kjo tregon performancë jashtëzakonisht të dobët qeverisëse. Tek përmbledhja e shpenzimeve sipas drejtorive për periudhën raportuese për të cilën po flasim tek kodi ekonomik 160 për gjashtë muaj, kryetari i komunës ka shpenzuar afër 103.000.00 € që i bie se kryetari i komunës ka pasur ditë pune 120 ditë, kjo matematikisht i bie se kryetari i komunës për çdo ditë pune mesatarisht ka shpenzuar 858.033 €, dhe kjo pa i llogaritur shpenzimet e mëditjeve për të cilat asnjëherë nuk është arsyetuar se çka ka përfituar komuna prej këtyre vizitave dhe gjithashtu këtu nuk janë futur as shpenzimet e telefonisë, ato të derivateve, shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve, si dhe pagesa e marrjes me qira e automjeteve. Andaj lidhur me këto pyeti kryetarin e komunës se çka nuk po funksionon këtu dhe se a janë mashtrim deklarimet e kryetarit të komunës për shpenzimet ditore të cilat ai i deklaronte apo se ky raport nuk është i saktë. Pastaj vlerësoi se nëse krahasohen shpenzimet e kryetarit të komunës me shpenzimet që ka bërë kuvendi bashkërisht me sekretarinë, atëherë nga kodi ekonomik 169 del se shpenzimet për 35 anëtarët e kuvendit janë afër 67.000.00 €. Tek kodi ekonomik 13141 shpenzimet për mallra dhe shërbime pozicioni mëditje për vizita jashtë vendit, kryetari ka autorizuar dhe ka shpenzuar hiç më pak se 10.419.060 €, ose 7000 € më shumë sesa qeveria e kaluar për të njëjtën periudhë të viti 2017. Tek kodi ekonomik 13310 shpenzimet e internetit janë rritur për 300 € më shumë, kodi ekonomik 13320 telefonia mobile dhe kodi ekonomik 13330 shpenzimet postare janë shpenzuar afër 19.000.00 € ose 7000 € më shumë se sa në qeverinë Mulaku. Kodi ekonomik 13360 furnizime shëndetësore në këtë pozicion është shumë interesant se ka kursime, ku afër 21.000.00 € kjo qeveri ka investuar më pak sesa qeveria e kaluar për përrudhën e njëjtë, andaj këtu shihen gabimet në investime sepse aty ku është dashur të kemi kursim të parasë publike aty kemi rritje të shpenzimeve dhe aty ku duhet të investojmë në ngritjen e shërbimeve aty ka kursim. Kodi ekonomik 13640 furnizime për kursyer për periudhën gjashtëmujore, ndërsa shkollat ballafaqohen me mungesën elementare të gjërave për pastrim dhe mirëmbajtje. Për të gjitha këto në përgjithësi dhe për deklarimet e shpenzimeve javore të kryetarit të komunës në veçanti kërkoi sqarime zyrtare nga udhëheqja komunale.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – njoftoi se Drejtoria për Buxhet dhe Financa i ka kthyer përgjigje, dhe ai ka kuptuar se kryetari i komunës i shfrytëzon beneficionet e telefonit dhe beneficionet tjera sipas ligjeve në fuqi dhe gjithashtu bëri të ditur se kryetari i komunës në mbledhjen e KPF-së është zotuar që në fund të muajit do të dalë me të gjitha shpenzimet.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me raportin janar-qershor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet, duke krahasuar se shpenzimet për investime kapitale për vitin e kaluar për përuhdën e njëjtë janë shpenzuar 739.564.00 €, ndërsa për përuhdën e njëjtë të këtij viti janë shpenzuar 494.169.00 €, që i bie se janë 245.000.00 € më pak dhe kjo nuk është shifër alarmante ashtu siç u paraqit më herët nga anëtari i kuvendit z.Azemi. Sa i përket shpenzimeve nga zyra e kryetarit, kryetari i komunës ka shpenzuar 15.0000 € më pak nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar, kurse sa i përket rritjes së shpenzimeve për mëditje është realitet se kur kemi ndërrim të qeverisë ka më shumë trajnime dhe rrjedhimisht rriten edhe shpenzimet. Lidhur me shpenzimet e telefonisë njoftoi se janë bartur tri fatura nga viti i kaluar. Në fund tha se disa projekte nga viti i kaluar kanë përfunduar në fund të vitit dhe kështu ka pasur vonesa për shkak të afatit për alokimin e buxhetit nëpër agjencitë shpenzuese.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi Raportin janar-qershor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet e Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Ahmet Krasniqi” në Vushtrri

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – përsëriti se oborri i objektit të komunës nuk është i përshtatshëm dhe në të njëjtën kohë nuk është dinjitoz që të emërohet sheshi “Ahmet Krasniqi” si dhe duke parë përpjekjet e kryetarit të komunës që kësaj çështjeje t’i jepet konotacion politik, deklaroi se si Lëvizje për Bashkim nuk do të marrin pjesë në votim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet emërtimi i sheshit „Ahmet Krasniqi” pranë objektit të ri të Komunës në Vushtrri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat mbi të drejtën e pronës, kopjet e planit dhe projekti ideor lidhur me ndërtimin e këtij sheshi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të kuvendit të komunës janar-qershor 2018

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - njoftoi kuvendin se vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë Akademisë Policore, gjendet në procedurë të zbatimit pasi që aty do të ndërtohet Fakulteti i Sigurisë, por ideja e komunës është që edhe objekti i QKMF-së të ndërtohet në të njëjtën parcelë pasi që kjo është më e përshtatshme dhe do të ndikojë në shkarkimin e qytetit. Pastaj ceku se vendimi për ndërtimin e zonës ekonomike në Lumadh është duke u zbatuar, vendimi për procedurat e funksionalizimit të zonës ekonomike gjithashtu gjendet në procedurë të zbatimit, vendimi për shtëpinë në fshatin Ropicë gjithashtu është në procedurë të zbatimit. Këto vendime janë të karakterit afatgjatë dhe kërkojnë një kohë më të gjatë deri në implementimin e tyre përfundimtar.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – kërkoi sqarime lidhur me një numër të vendimeve të aprovuara në legjislaturën e kaluar, të cilat nuk janë zbatuar për këtë kërkoi përgjigje me shkrim.

7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2017/2018

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - njoftoi kuvendin se në lëmin e arsimit ka filluar një praktikë e re ku nxënësit të cilët kanë treguar rezultate të larta në testin e arritshmërisë komuna do t'iu ndajë mirënjohje dhe një shpërblim modest prej 100 €, me qëllim të stimulimit të nxënësve në suksese të reja. Pastaj njoftoi se si rezultat i menaxhimit të mirë në fushën e arsimit, komuna do të fillojë me pagesën e mësimdhënësve për nivelin parashkollor në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, dhe për këtë më nuk do të ketë nevojë për vetfinancim nga prindërit.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – pyeti se çfarë bashkëpunimi ka Drejtorja e Arsimit me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.

Agim Miftari, zyrtar në DA - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me informatën dhe u përgjigj në pyetjet a anëtarit të kuvendit.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se nga raporti shihet se kemi mjaft të arritura dhe rezultate dhe posaçërisht përshëndeti veprimin për stimulimin e nxënësve me shpërblim, të cilët kanë treguar rezultate në testin e arritshmërisë. Megjithëkëtë e indinjon fakti se këta nxënës të suksesshëm nuk po mund ta kalojnë pragun e provimit pranues në fakultet. Tutje vlerësoi se organizimi dhe pagesa nga fondi publik i arsimit parashkollor është një hap më rëndësi që meriton të përshëndetet, por nëse mendohet se për një afat prej gjashtë muajve do të shihen rezultatet në fushën e arsimit, atëherë ky është gabimi, sepse rezultatet në arsim do vërehen tek pas afati pesëvjeçar, atëherë kur nxënësit tanë do të ballafaqohen me tregun, konkurrencën dhe me nxënësit tjerë të komunave tjera.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se është hap me rëndësi fillimi i organizimit të mësimit parashkollor dhe për këtë ka filluar edhe rekrutimi i personelit mësues. Dhe në të njëjtën kohë ceku se deri tash ky nivel i arsimit nuk ka qenë i organizuar si duhet e për më keq në aspektin e pagesës së mësimitdhënësve ka qenë diskriminues. Pastaj personeli mësues në të kaluarën nuk ka qenë i kualifikuar dhe në shumë raste të punësuarit janë bërë me direktiva politike. Në fund ai u zotua se gjendja tash e tutje do të ndryshojë dhe personeli do të përzgjidhet konform ligjit dhe udhëzimit administrativ.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se duhet të intensifikohet bashkëpunimi mes të gjithë akterëve dhe të kemi shmangie nga interferimet politike gjatë rekrutimit të personelit arsimor me qëllim që arsimin ta shtyjmë përpara.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – tha se është për t'u përshëndetur iniciativa për pagesën nga komuna e stafit të mësimit parashkollor dhe pyeti se si ka mundësi të punësohen 11 punëtorë dhe mos të rritet numri i të punësuarve në arsim, si dhe si do të mbulohet i tërë spektri i shkollave prej 40 syresh niveli i mësimit parashkollor me vetëm 11 mësimitdhënës. Pastaj përshëndeti vendimin për subvencionimin me nga 100 € për nxënësit që tregojnë rezultate, dhe njoftoi se këtë vit tre nxënësit që janë shpërblyer vijnë nga shkolla fillore "Migjeni" në Stanoc të Epërm", por megjithëkëtë sukses drejtori i asaj shkolle është larguar nga vendi i punës për t'u zëvendësuar me një tjetër dhe kjo nuk e di se a po bëhet në baza politike apo me çfarë arsye. Pastaj ai përshëndeti bashkëpunimin që ka pasur shkolla profesionale "Bahri Haxha" me një organizatë suedeze ku ka pasuar edhe një vizitë nga mësimitdhënësit e kësaj shkolle në Suedi, por për çudi dy nga mësimitdhënësit që kanë qenë në atë vizitë janë të lëmit përkatës nga ekonomia, kurse një mësimitdhënës që nuk është fare punëtorë e asaj shkolle ka qenë në atë vizitë e që ka rastisur që kjo mësimitdhënësja në fjalë të jetë motra e gruas e kryetarit të komunës.

Agim Miftari, zyrtar në DA - dha përgjigje në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se vendimi që të stimulohen nxënësit të cilët kanë pasur rezultate të larta në testin e arritëshmërisë me nga 100 € a është analizuar si duhet dhe një vendim të tillë a kanë marrë edhe komunat tjera apo vetëm Komuna e Vushtrrisë. Lidhur me këtë ai vlerësoi se subvencionimi i disa nxënësve mos po shkakton ndonjë indinjatë dhe mos po jep ndonjë rezultat jo produktiv e demotivues tek nxënësit tjerë.

8. Shqyrtimi i Informatës për sigurinë ushqimore

9. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Draft-Memorandumit të Bashkëpunimit i lidhur mes Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës, Skënderajt, Drenasit dhe Obiliqit

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - paraqiti sqarime lidhur me këtë çështje duke shtuar se arritja e këtij memorandumit të mirëkuptimit është iniciativë e përbashkët e pesë komunave që gravitojnë rreth malit Çiçavica, ku është hedhur ideja që të ndërtohet rruga në gjatësi prej 18 km, e cila fillon rreth Obiliqit, vazhdon tek fshati Gradicë (Komuna e Drenasit) dhe përfundon tek Mitrovica. Lidhur me këtë do të hartohet projekti detaj i cili do t'i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës në emër të pesë komunave. Ky projekt është menduar që do ta ngjallë ekonomikisht këtë zonë dhe do ta shndërrojë malin e Çiçavicës në një zonë atraktive turistike për vizitorë. Andaj nga të cekurat më lartë kërkojmë nga kuvendi që ta përkrah këtë memorandum pasi aprovimi i tij është kërkesë e ligjit dhe ngjashëm do të veprojnë të gjitha komunat palë të këtij memorandumit të mirëkuptimit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se shpreson që ky projekt të jetësohet në praktikë, pasi që edhe më herët ka ekzistuar një projekt i tillë në pjesën e komunës në anën lindore të saj, por ajo ishte mbetur vetëm ide në letër.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - pyeti se shpallja zonë me interes të përgjithshëm a do të ndikojë në ruajtjen nga prerja ilegale e malit Çiçavica, sepse kohëve të fundit këto sipërfaqe pyjore janë dëmtuar shumë nga prerjet ilegale.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - përsëriti se është mjaft me interes që po aprovohet ky memorandum i mirëkuptimit, ku hapet rruga që në këtë zonë të futen investimet dhe shtoi se personalisht nuk e përkrah idenë që mali Çiçavica mos të shpallet park nacional pasi që në atë modalitet bëhen të pamundura investimet nga sektori privat.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se kjo ide është mjaft e qëlluar dhe shpreson se kjo do të realizohet në praktikë, pasi që një projekt tjetër kishte ekzistuar edhe më herët për pjesën tjetër nga shala deri tek fshati Lupç - Komuna e Podujevës ku ishte involvuar edhe Komuna e Mitrovicës dhe ajo e Obiliqit, mirëpo ky projekt asnjëherë nuk ishte realizuar në praktikë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se ky projekt që është lansuar nuk do ta lërë nën hije projektin që ka ekzistuar në rajonin e shalës pasi që komuna jonë e ka përfunduar rrugën deri tek fshati Gumnishtë, gjithashtu edhe Komuna e Mitrovicës e ka përfunduar pjesën e vetë, ndërsa tani mbetet që Komuna e Podujevës të kryejë pjesën e saj diku nga fshati Popovë. Pastaj në funksion të ruajtjes dhe faktorizimit të veriut udhëheqja komunale e ka propozuar Oden Ekonomike Amerikane pikërisht në kodrat e Banjskës dhe kjo mendohet që do të ndikojë pozitivisht si një infuzion në zhvillimin ekonomik të këtij rajoni.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet memorandumit i mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Skënderajt, Mitrovicës, Drenasit dhe Obiliqit.

2. Qëllimi i këtij memorandumimi të mirëkuptimit është që pasuria natyrore e Bjeshkëve të Çiçavicës, e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të përfshira në këtë memorandum të mirëkuptimit, të shpallet zonë me interes të përgjithshëm.

3. Autorizohet Kryetari i komunës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit, si dhe t'i marrë përsipër obligimet që burojnë nga ky dokument me qëllim të implementimit të këtij memorandumimi të mirëkuptimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

b). Shqyrtimi i Draft-Planit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018 (shqyrtimi i dytë)

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018.

2.Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të rritjes së transparencës dhe avancimin e efektivitetit në aktivitetin dhe veprimtarinë e Komunës së Vushtrrisë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Zyra e komunikimit me publikun dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018”.

5.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Ejonë Hasanin

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - njoftoi kuvendin se ndihma financiare e cila po i ofrohet të lartpërmendurës bazohet në një marrëveshje që ka Komuna e Vushtrrisë me “Kosova Hope” të cilët kanë zgjedhur pesë nxënës nga e gjithë Kosova për të shkuar në SHBA dhe ata pas seleksionimit kanë bërë përzgjedhjen e kësaj nxënëse dhe tani ftoi kuvendin që të aprovojë këtë ndihmë financiare. Pastaj ai njoftoi se në kuadër të bashkëpunimit me qytetin e Norwalk të Iowa-s (SHBA) do të angazhohen për shkëmbimin dhe dërgimin e nxënësve dhe studentëve për studime në SHBA.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se nxënësja si Ejonë Hasani është vërtet krenari për qytetin e Vushtrrisë, andaj apeloj tek anëtarët e kuvendit që ta votojnë këtë propozim-vendim.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – kërkoi që hartuesi i këtij propozim-vendimi të ofrojë para kuvendit një biografi të shkurtër për përfituesen e këtyre mjeteve Ejonë Hasani, ashtu që para aprovimit të këtij propozimi kuvendi ta ketë një pasqyrë të plotë dhe të sakë se çfarë po voton.

Agim Miftari, zyrtar në DA - paraqiti një biografi të shkurtër për Ejonë Hasanin.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumën prej dy mijë euro (2000 €), Ejonë Hasanit, nxënës në gjimnazin „Eqrem Çabej” në Vushtrri” e cila do të marrë pjesë në programin e këmbimit të nxënësve Kosovë-SHBA.

2. Programi do të mbahet në „Providence Academy” në Lilburn GA të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku nisja do të bëhet më datë 7 tetor 2018, kurse kthimi më datë 4 nëntor 2018.

3. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të ndahet nga kategoria subvencione dhe transfere me kod ekonomik 21200 subvencione për etnitete jopublike nga Drejtoria e Arsimit.

4. Pagesa e mjeteve financiare do të bëhet në emër të Bashkim Hasanit, (babai i Ejonë Hasanit).

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për Arben Krasniqin

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – kërkoi të sqarohet se përse materialet që kanë të bëjnë me pronat gjithherë vijnë me vonesë në kuvend.

Berat Sadiku, drejtor DUMM-së - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë ku ceku se bëhet fjalë për Arben Krasniqin i kthyer nga Gjermania ku njoftoi se për ndërrimin e destinimit të kësaj prone është marrë pëlqimi nga ministria gjegjëse, andaj kërkoi që kjo çështje të aprovohet nga ana e kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për Arben Krasniqin në parcelën kadastrale me Nr.P-70202010-00130-1 me kulturë arë e klasës së 4 (katër), ZK-Bukosh me sipërfaqe prej 485.92 m² (katërqind e tetëdhjetë e pesë e nëntëdhjetë e dy metra katrorë) e cila sipërfaqe kërkohet për shndërrim nga sipërfaqja e përgjithshme e P-70202010-00130-1 që është 3089m² dhe e cila është evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme Nr. i lëndës 18-1007-18 në emrin e Halit (Sinan) Krasniqit, babai i Arben Krasniqit ZK-Bukosh.

2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është ndërtimi i objektit për banim individual – shtëpi në vendin e quajtur „Licanski Breg/Golo Brdo” në parcelën kadastrale të cekur si në pikën një (1) të këtij vendimi.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të cekur në pikën e dytë të këtij vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 pika „a” të Udhëzimit administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr. 41/2006 përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat e pronësisë, kopja e planit, pëlqimi i dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e çmimit “Hasan Prishtina” për Enver Zymberin (post mortum).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Enver Zymberit (post mortum) i ndahet çmimi “Hasan Prishtina” në rastin e mbajtjes së manifestimit “Ditët e Hasan Prishtinës”, në muajin gusht 2018.

2. Autorizohet Kryetari i komunës që në ditën e mbajtjes së këtij manifestimi t’ia dorëzojë këtë çmim – dekoratë, familjarit të të ndjerit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – pyeti drejtorinë kompetente lidhur me prerjet e rrugëve (asfaltit), ku për këtë a kemi leje paraprake për një gjë të tillë dhe nëse po atëherë a ka ndonjë afat për sanimin e atyre hapjeve në rrugë. Ai ceku se këto prerje janë bërë në rrugën “Jeton Terrstena” në rrugën afër gjimnazit dhe në disa rrugë tjera.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – sqaroi se disa subjekte kërkojnë leje paraprake për prerje të asfaltit dhe vlerësoi se ai ndanë mendimin që për leje të tillë duhet të specifikohet që kthimi në gjendjen e mëparshme të bëhet me riasfaltim të rrugës e jo siç ka ndodhur në të kaluarën me vendosje të kubëzave beton apo në disa raste mbulimi me zhavorr.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e lagjes “Hys Popova”, ku në këtë lagje kemi frekuentim të madh të të rinjve dhe ka dyshim për përdorim të substancave narkotike dhe vjedhje të ndryshme, në ç’rast janë dëmtuar pronat e këtyre banorëve. Andaj në këtë aspekt kërkohet që të veprohet konform ligjit dhe të kemi shtim të masave të sigurisë. Në kuadër të kompetencave të komunës kërkohet të vendosen shenja kufizuese të shpejtësisë dhe vendosjen e të paktën e dy pengesave për zhvillimin e shpejtësisë së automjeteve, zëvendësimin e llambave ndriçuese, të cilat janë jashtë funksionit, largimin e kontejnerëve dhomë, ndalimin e parkimit të automjeteve, si dhe largimin e materialeve të forta nga fusha sportive e hendbollit e cila është zonë publike. Pastaj në hyrje të lagjes dy kontejnerë të mbeturinave që gjenden në rrugë të hiqen nga aty dhe të vendosen në mënyrë më të përshtatshme ku do të krijohet hapësirë

më e madhe. Vendosja e katër llambave ndriçuese projekt në fushën e hendbollit, mirëmbajtjen e zonës së gjelbërt të zonave publike ku tash e sa kohë nuk është duke u mirëmbajtur. Në fund adresoi pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë ku ceku se në dhomën për vaksinimin e fëmijëve, nuk ka përgjegjës për vaksinë, por aty punon vetëm një motër infermiere, mandej pyeti se përse në laboratorin e analizave në Qendrën e mjekësisë familjare nuk ka shef të laboratorit tash e disa vite, ku si rezultat i kësaj raportet e analizave i nënshkruajnë personat jo adekuat.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së – lidhur me përgjegjësinë për vaksinim ceku se këtë përgjigje do ta adresojë me shkrim, ndërsa sa i përket shefit të laboratorit njoftoi se në kuadër të normativit për sistematizim të vendeve të punës ka *përgjegjës të laboratorit*, ndërsa njoftoi se janë në procedura të rekrutimit të shefit të diagnostikës i cili sipas rregullores për sistematizim mund të jetë specialisti i biokimisë ose specialisti i radiologjisë, por në kuadër të udhëzimit administrativ radiolog nuk ka dhe kjo i bie që këtë vend ta mbulojë specialisti i biokimisë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – përsëriti kërkesën e tij lidhur me riemërtimin e një rruge në lagjen “Januzaj” në fshatin Pasomë ku ajo rrugë është emërtuar “Shaban Tahiri” dhe po në atë lagje gravitojnë afërsisht 13 familje të lagjes “Januzaj” në fshatin Pasomë andaj kërkoi nga Drejtoria e Urbanizmit që të merret me korigjimin e atij emri, respektivisht me riemërtimin e asaj rruge. Mandej shtoi se në fshatin Akrashticë meriton që ndonjë rrugë të emërtohet me emrin e Hatique Tërrstenës, nëna e Sherif Tërrstenës. Pastaj shtoi se edhe bashkëshortja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe bashkëshortja e Rifat Jasharit e kanë prejardhjen nga fshati Akrashticë dhe ndonjë rrugë në komunë tonë meriton të marrë emrin e tyre për kontributin e tyre në rezistencë ndaj armikut serb.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – kërkoi nga strukturat komunale kryetari dhe nënkryetari i komunës që të dalin dhe të shikojnë punimet në rrugën e Artakollit nga fshati Bukosh-Gllavatit, ku po mbretëron një gjendje jashtëzakonisht e tmerrshme gjendje kaosi, ku pluhuri i madh që po shkaktohet nga punimet shkon deri 100 metra lartësi, madje gropat dhe shkatërrimi i rrugës i ka bllokuar banorët e atyre fshatrave.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – tha se do të bëjë përpjekje që të bisedojnë me ministrinë gjegjëse që ky projekt të shtyhet përpara që të përfundojë sa më parë që të jetë e mundur.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së – sqaroi se vaksinimi i fëmijëve në sistemin parësor shëndetësor nuk realizohet vetëm në një qendër, por në disa qendra. Pastaj njoftoi se komuna jonë është ndër më të suksesshmet sa i përket vaksinimit ku për këtë falënderoi stafin përgjegjës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – duke iu referuar Rregullores të Punës së Kuvendit, adresoi obligimin që anëtarët e kuvendit t’i kenë kartelat identifikuese, mandej të kenë llogarinë adresën elektronike zyrtare, të cilat duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës. Gjithashtu në kuadër të obligimeve të rregullores ku komuna duhet t’u sigurojë pajisje, mjete të nevojshme për anëtarët e kuvendit, kërkoi që anëtarët e kuvendit të pajisen me llaptop. Në fund tha se prioritetet për projektet kapitale duhet të bëhen në bashkërendim me këshillat e fshatrave dhe me asamblastët e atij lokaliteti ku gravitojnë, mirëpo kjo nuk ka ndodhur në fshatrat Stanoc i Poshtë dhe Stanoc i Epërm pasi që strukturat komunale fare nuk i kanë përfillur përfaqësuesit e fshatit dhe as asamblastët e atij lokaliteti. Në fund ai kërkoi përgjigje me shkrim nga Drejtoria e Urbanizmit se cilat kanë qenë kriteret që janë marrë për bazë për caktimin e prioritetëve për shtrimin e rrugëve me asfalt në fshatin Stanoc i Poshtë dhe Stanoc i Epërm.

Mbledhja përfundoi në ora 15:10.

Bastri Duraku

Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit